

Kalimi nga shkolla fillore në shkollat e mëtejshme

- Pas shkollës fillore fëmija im do të ndjekë **një shkollë të mëtejshme**. Për kalimin nga shkolla fillore në shkollat e mëtejshme fëmijës i duhet mbështetja e prindërve.
- **Vendimi** për ndjekjen e një shkolle të mëtejshme i **përket prindërve**. Vendimi bazohet në atë që fëmija im di dhe mund të bëjë deri në fund të klasës së 4-të. Prindërit e marrin këtë vendim në interes të fëmijës.
- Nga **forma të ndryshme shkollore** prindërit zgjedhin të duhurën për fëmijën e tyre: Shkollë 9-vjeçare/shkollë pas 9-vjeçares, shkollë e përgjithshme, gjimnaz.
- **Për fillimin e klasës së 4-t** dhe kalimin nga shkolla fillore në një shkollë të mëtejshme **bëhet një informim** i prindërve. Këto informacione prindërit i marrin në shkollën fillore. Është e rëndësishme që prindërit ta shfrytëzojnë këtë mundësi për informim. Gjatë klasës së 4-t prindërit vendosin se cilën shkollë të mëtejshme do të ndjekë fëmija e tyre.
- Për të gjithë prindërit organizohet një **bisedë informimi dhe këshillimi** me mësuesit. Pas bisedës mësuesi apo mësuesja bën rekomandimin e vet. Aty shkruhet se çfarë lloj shkolle duhet të ndjekë fëmija. Ky quhet **rekomandim i shkollës fillore**. Këtë rekomandim të shkollës fillore prindërit e marrin jo më vonë se 1 mars i vitit kur mbaron klasa e 4-t, me shkrim nga shkolla.
- Pastaj **prindërit e regjistrojnë fëmijën e tyre në një shkollë të mëtejshme**. Për këtë ekzistojnë takime fikse. Kur regjistrohen në një shkollë në Baden-Württemberg, prindërit paraqesin rekomandimin e shkollës fillore.
- Ndonjëherë prindërit nuk janë të sigurt se çfarë shkolle të mëtejshme duhet të frekuentojë fëmija e tyre. Ndonjëherë prindërit nuk janë dakord me rekomandimin e shkollës fillore. Atëherë ekziston mundësia e pjesëmarrjes në një **procedurë të veçantë këshillimi**. Regjistrimi në kohë është i nevojshëm për këtë procedurë të veçantë. Është e rëndësishme që fëmija të regjistrohet gjithsesi në një shkollë. Takimin për këtë e di shkolla fillore.
- Në shkollat e mëtejshme jepen **lëndë të ndryshme** ku **disa prej të cilave mund të zgjidhen**. Fokuset e shkollave të mëtejshme janë të ndryshme.
- Nxënësit duhet të marrin një **arsim të përgjithshëm** në shkollat e mesme dhe të mësojnë **njohuritë që u nevojiten për formimin profesional ose studimet universitare**.
- **Në shkollat e mëtejshme** ka shumë **shërbime informimi**: Evenimente informimi, ditët e dyerve të hapura, ... Aty mund të marrin pjesë prindërit dhe fëmija e tyre dhe të njihen me shkollën.

- **Vendimi** për zgjedhjen e shkollës së mëtejshme është **i rëndësishëm**. Prandaj prindërit duhet të informohen dhe të mendojnë me kujdes së bashku me fëmijën e tyre.